



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2773/11 prot

Datë 21.12.2023

V E N D I M

Nr. 1345/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|------------------|------------|
| Jonaid Myzyri | Kryetar |
| Fiorent Zguro | Nënkryetar |
| Anila Malaj | Anëtar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 21.12.2023 me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Armand Sinani” PF në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-77994-08-21-2023, me objekt: “*Këpuce me qafa*” për nevojat e shoqërisë “*ILLYRIAN GUARD*” Sh.A”, me fond limit 15,810,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 19.10.2023 nga autoriteti kontraktor, “Illyrian Guard” Sh.A.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Autoriteti Kontraktor: “Illyrian Guard” Sh.A, me adresë: Rruga “Ibrahim Rugova”, 1016, Tiranë

Ankimues: Operatori ekonomik “Armand Sinani” PF, me NIPT L22301008D, me adresë: Njësia Bashkiake Nr.9, Rruga “Jordan Misja”, Kompleksi Gener 2, Kati -1, Parkimi Nr.2, Tiranë

Subjekte të Interesuar: Operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF, me NIPT L12330004A, me adresë: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Kulla Nr.2, kati i dytë, Tiranë.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 05.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 22.08.2023 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-77994-08-21-2023, me objekt: “*Këpuce me qafa*” për nevojat e shoqërisë “*ILLYRIAN GUARD*” Sh.A”, me fond limit 15,810,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 19.10.2023 nga autoriteti kontraktor, “*Illyrian Guard*” Sh.A.

II.2. Në datën 02.11.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|-------------------------|-------------------------------|
| 1. “Armand Sinani” PF | 13,477,500 lekë, skualifikuar |
| 2. “Vojsava Zenelaj” PF | 14,400,000 lekë, kualifikuar |

II.3. Operatori ekonomik “Armand Sinani” PF rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshte:

OE Armand Sinani (person fizik) ka paraqitur një palë këpucë si mostër, si dhe fletët e analizave me mostrat fizike përkatëse.

Në dokumentin e “ILLYRIAN GUARD”, me nr.1028/4, dt. 16.06.2023, “Procesverbal – Tipi i kontratës – Mall”, te ngarkuar ne sistem me emertimin “argumentimi i Specifikimeve Teknike (kepuce me qafa)” per nevojat e shoqerisë ILLYRIAN GUARD Sh.a, është specifikuar se: “...komisioni vendosi që këpuca me qafa të jetë me paraqitje të njëjtë me këpucën aktuale të përdorur të shoqërisë me qëllim që furnizimi me këpucë të ruajë uniformitetin brenda shoqërisë”.

Sipas modelit të zgjedhur për këtë qëllim janë përpiluar Specifikimet Teknike.

OE i lartpërmendur nuk ka respektuar kërkesën për prodhimin e modelit të kërkuar, ku KVO vëren se OE ka bërë këto devijime nga forma dhe paraqitja e këpucës:

1. Këpucët janë qepur me fill në ngjyrë të kuqe, ndërkohë që kërkesa e klientit është që këpuca duhet të jetë me ngjyrë të zezë. Kjo gjë nuk përputhet me modelin e paraqitur në foto dhe shprehur me fjalë në kërkesat e specifikimeve teknike ku shprehet se ngjyra e këpucës të jetë e zezë.

2. Mbërthimi dhe lirimi i këpucës është realizuar me zinxhirë në pjesën e përparme të këpucës, ndërkohë që në kërkesat e specifikimeve teknike është kërkuar të jetë me lidhëse. Kjo gjë jo vetëm është në kundërshtim me kërkesat e specifikimeve teknike të kërkuara, por ky fakt sjell një devijim të uniformës, pasi do të kishim dy lloje modelesh në përdorim deri në kalimin e gjithë personelit në këpucën e re, për shkak edhe të afatit të përdorimit të tyre, i cili është i ndryshëm dhe i lidhur me afatin e vënies në përdorim të këpucëve ekzistuese nga përdoruesit. Kërkesa e specifikimeve teknike citon në pikën 3 të saj se: “këpuca duhet të ketë 16 unaza bronxi në ngjyrën e këpucës dhe lidhese të zezë rreth 125 cm”, dhe specifikon mbërthimin e këpucës me lidhëse.

3. Në specifikimet teknike është kërkuar që këpuca të ketë 16 unaza bronzi në të dy anët e saj për të siguruar lidhjen e saj ndërkohë që këpuca mostër e paraqitur ka gjithsej 36 unaza bronzi të vendosura në 4 rrjeshta në vrimat e hapura për lidhje.

4. Në pjesën e pasme këpuca mostër ka 6 tegele zbukurimi me penj të kuq, ndërkohë që në specifikimet teknike nuk ka asnjë tegel zbukurues përveç tegelit të qepjes së thembrës, duke u shmangur krejtësisht nga modeli i paraqitur në specifikime.

5. Këpuca nga provat praktike të kryera me disa përdorues rezulton të jetë shumë statike dhe jo e përshtatshme për lëvizje të lirshme dhe të shpejta, këto në funksion të situatave operacionale që shoqëria jonë duhet të kryejë, si dhe mbajtjen për një kohë të gjatë të tyre në shërbim.

6. Në përfundim shprehemi se ky product nuk përmbush specifikimet teknike të kërkuara dhe nuk është i përshtatshëm për Shoqërinë “Illyrian Guard” Sh.a.

II.4. Në datën 03.11.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraparak në SPE.

II.5. Në datën 09.11.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. 2773/2023 datë 09.11.2023 e operatorit ekonomik “Armand Sinani” PF ,për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraparak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Armand Sinani” PF, si dhe skualifikimin e operatorit ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 2773/2 date 10.11.2023, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Armand Sinani” PF, si dhe kriteret të cilat pretendohen se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF.

II.7. Me datën 14.11.2023, protokolluar me tonën me nr.2773/3 prot., operatori ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF, ka paraqitur formularin e paraqitjes së argumenteve në cilësinë e subjektit të interesuar në kuptim të nenit 113 të LPP-së, duke respektuar afatet ligjore të paraqitjes së tyre.

II.8. Me shkresën nr. 1028/64 prot, datë 17.11.2023 me objekt: “Dërgim vendimi mbi ankesën nr.2773/2023 prot., datë 09.11.2023, prot me tonën nr. 1028/59 datë 09.11.2023, paraqitur nga OE “Armand Sinani” protokolluar me tonën me nr. 2773/4 datë 21.11.2023, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Armand Sinani” PF, ku konstatohet, se ankesa e këtij të fundit është refuzuar. Gjithashtu, konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës

ka shtuar gjithashtu: “Krahas sa me sipër, KSHA ka evidentuar edhe faktin se KVO duke qene se kishte paqartesi në lidhje me dokumentin e paraqitur në funksion të plotesimit të kërkesës për kualifikim, sipas pikës 2, të Kapacitetit Teknik 2.3 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, të percaktuara në DT. Konkretisht bëhet fjalë për dokumentin e paraqitur nga OE Armand Sinani si marrëveshje Bashkëpunimi me "CALZATURIFICIO 5 BI SR", pasi dokumenti me nr 7/1 si dhe dokumenti 7/2 të ngarkuar në SPE nuk kishin lexueshmeri të qartë të vulave të noterizimit si dhe në dokumentin 7/2 nuk kishte fare dokument noterizimi. Komisioni u vu në vështirësi të vendimmarrjes për këtë operator. Gjithsesi meqenëse pjesëmarrës në tender ishin vetëm dy OE dhe për të mos e përjashtuar nga pjesëmarrja në tender OE Armand Sinani, komisioni vendosi që të kërkojë të ngarkojë në sistem dokumentacionin e kërkuar me qartësi më të mirë të fotove të ngarkuara. Nga ana e tij OE Armand Sinani bëri noterizim të ri të dokumentave të dyshuar 7/1 dhe dokumentit të pa noterizuar fare që mbante numërin 7/2. Në të njëjten logjikë për sqarimin e problemit KVO ju drejtua me email prodhuesit "CALZATURIFICIO 5 BI SR", për të sqaruar nëse dokumenti i paraqitur nga OE Armand Sinani ishte autentik ose jo. Kaloi një periudhë pritje që ishte me tepër se një javë ku KVO nëpërmjet edhe 2 e-maileve të tjera i ka kërkuar përgjigje "CALZATURIFICIO 5 BI SR" për dokumentin e paraqitur nga OE Armand Sinani. Meqenëse përgjigja u vonua dhe procedura duhej mbyllur, KVO ka vendosur që të mbyllë çështjet e dokumentacionit duke e kualifikuar OE Armand Sinani në dokumentat e tenderit. Gjithsesi edhe pse me vonë në dt. 2 Nëntor 2023, nderkohe që ishte mbyllur raportimi në SPE, erdhi përgjigja nga kompania Italiane "CALZATURIFICIO 5 BI SR" e pretenduar si bashkëpunuese me OE Armand Sinani. Në këtë përgjigje nuk jepej asnjë e dhënë për atë që KVO kishte kërkuar, vertetësinë e dokumentit "marrëveshje bashkëpunimi" por thjesht jepej përgjigje se "Z. Armand Sinani shtet një nga klientet/distributorët tanë në Shqipëri. Për çdo informacion tjetër ju lutemi kontaktoni atë. Kjo përgjigje e ardhur në ditën e enjtes, 2 Nëntor 2023 12:26:19 PM +01,00 nuk tregon se dokumenti i paraqitur si marrëveshje bashkëpunimi për të cilin shtet insistuar të merret përgjigje nga kompania Italiane "CALZATURIFICIO 5 BI SR, ishte dokumenti autentik që Z. Armand Sinani e ka paraqitur në Dokumentat e Tenderit (shih e-mailet bashkëlidhur). Për më tepër marrëveshja e bashkëpunimit me operatore të tjera kërkon nëse prodhuesi merr për siper specifikisht të prodhojë mallin objekt prokurimi me numërin specifik të REF, me objekt "Kepuce me qafa", REF-77994- 08-21-2023. Veç t tjerash në marrëveshjen e bashkëpunimit duhet të përcaktohet nëse prodhuesi i përgjigjet specifikimeve teknike të percaktuara dhe sasise se përcaktuar në tender. Marrëveshja e paraqitur nuk e përmbush këtë kërkesë. E gjitha sa më lart shtet një mungesë e madhe për garancinë dhe sigurinë e prodhimit të kërkuar për Shogëri ILLYRIAN GUARD SHA. Marrëveshje në fjalë me titullin "Autorizim Prodhuesi" e dt 24.07.2023, e ngarkuar në sistem me numërin 7/1, thuhet se "nëpërmjet se ciles garantojme furnizimin e subjektit "Armand Sinani", person fizik me mallra për të cilat shogëria jone CALZATURIFICIOSBI" shpk, shfaqet në cilesinë e prodhuesit, si dhe të tregëtoje produktet tona në marrëdhënie me institucionet private dhe publike në teritorin e Republikës së Shqipërisë." Këtu shtet momenti të theksojme se ky OE shtet përjashtuar njëherë në dt 07.02.2023 nga Pjesëmarrja në tender me Nr.Reference REF-55499-12-29-2022, për shkak se ka paraqitur të njëjtët këpucë që ka paraqitur edhe në tenderin në fjalë. Këpucët e paraqitura nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara dhe nuk përmbushin kërkesat tona.”

II.9. Më datë 24.11.2023, protokolluar me tonën me nr.2773/5 prot., operatori ekonomik “Armand Sinani” PF ka paraqitur formularin e paraqitjes së argumenteve në cilësinë e subjektivit të interesuar në kuptim të nenit 113 të LPP-së, duke ngritur pretendime mbi vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Anksës.

II.10. Nisur nga arsyet e skualifikimit dhe pretendimet e ankimuesit me anë të shkresës nr.2773/6 prot., datë 01.12.2023, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor informacion mbi procedurën e prokurimit, si dhe dorëzimin e mostrave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, konkretisht: “[...] Sa më sipër, referuar arsyeve të skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Armand Sinani” PF, si dhe pretendimeve të këtij të fundit për skualifikimin e operatorit ekonomik “Vojsava Zenelaj” PF, krahas informacionit të mësipërm, KPP kërkon nga autoriteti juaj të dorëzoni pranë institucionit tonë mostrat e paraqitura për këtë procedurë prokurimi, nga operatorët ekonomikë “Armand Sinani” PF dhe “Vojsava Zenelaj” PF, së bashku me dokumentacionin shoqërues të tyre, procesverbalin e mbajtur nga autoriteti kontraktor për administrimin e tyre, si dhe informacion të hollësishëm në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit. Me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, i gjithë informacioni dhe dokumentacioni i sipërcituar të dorëzohet pranë KPP-së, brenda ditës së nesërme të punës, nga marrja dijani e kësaj shkrese.”

II.11. Me shkresën nr. 1028/69 prot, datë 07.12.2023 me objekt: “Informacion KPP në përgjigje të shkresës tuaj Nr.2773/6 dt.01.12.2023 prot., me tonën 1028/66 datë 06.12.2023, Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Armand Sinani” PF protokolluar me tonën me nr. 2773/7 datë 07.12.2023, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor mbi procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi si dhe mostrat e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, të dorëzuara pranë autoritetit kontraktor.

II.12. Me shkresën nr.2773/8 prot., datë 14.12.2023, me qëllim gjyqimin e drejtë dhe objektiv të çështjes, KPP iu drejtua autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik “Armand Sinani” PF, për zhvillimin e një seance dëgjimore më datë 18.12.2023 në mjediset e KKP-së.

II.13. Në datë 18.12.2023, u zhvillua në mjediset e KPP-së seanca dëgjimore me përfaqësues të operatorit ekonomik “Armand Sinani” PF, si dhe të autoritetit kontraktor Illyrian Guard SHA. Seanca dëgjimore u regjistrua audio në sistemin e ankesave elektronike nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Armand Sinani” PF se arsyet e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike “1. Këpucët janë qepur me fill në ngjyrë të kuqe, ndërkohë që kërkesa e klientit është që këpuca duhet të jetë me ngjyrë të zezë. Kjo gjë nuk përputhet me modelin e paraqitur në foto dhe shprehur me fjalë në kërkesat e specifikimeve teknike ku shprehet se ngjyra e këpucës të jetë e zezë.

2. Mbërthimi dhe lirimi i këpucës është realizuar me zinxhirë në pjesën e përparme të këpucës, ndërkohë që në kërkesat e specifikimeve teknike është kërkuar të jetë me lidhëse. Kjo gjë jo vetëm është në kundërshtim me kërkesat e specifikimeve teknike të kërkuara, por ky fakt sjell një devijim të uniformës, pasi do të kishim dy lloje modelesh në përdorim deri në kalimin e gjithë personelit në këpucën e re, për shkak edhe të afatit të përdorimit të tyre, i cili është i ndryshëm dhe i lidhur me afatin e vënies në përdorim të këpucëve ekzistuese nga përdoruesit. Kërkesa e specifikimeve teknike citon në pikën 3 të saj se: “këpuca duhet të ketë 16 unaza bronzi në ngjyrën e këpucës dhe lidhese të zezë rreth 125 cm”, dhe specifikon mbërthimin e këpucës me lidhëse.

3. Në specifikimet teknike është kërkuar që këpuca të ketë 16 unaza bronzi në të dy anët e saj për të siguruar lidhjen e saj ndërkohë që këpuca mostër e paraqitur ka gjithsej 36 unaza bronzi të vendosura në 4 rrjeshta në vrimat e hapura për lidhje.

4. Në pjesën e pasme këpuca mostër ka 6 tegele zbukurimi me penj të kuq, ndërkohë që në specifikimet teknike nuk ka asnjë tegel zbukurues përveç tegelit të qepjes së thembrës, duke u shmangur krejtësisht nga modeli i paraqitur në specifikime.

5. Këpuca nga provat praktike të kryera me disa përdorues rezulton të jetë shumë statike dhe jo e përshtatshme për lëvizje të lirshme dhe të shpejta, këto në funksion të situatave operacionale që shoqëria jonë duhet të kryejë, si dhe mbajtjen për një kohë të gjatë të tyre në shërbim.

6. Në përfundim shprehemi se ky product nuk përmbush specifikimet teknike të kërkuara dhe nuk është i përshtatshëm për Shoqërinë “Illyrian Guard” Sh.a.”, nuk qëndrojnë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve standarde të tenderit, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” pika 2.3.6 autoriteti kontraktor ka përcaktuar:


6.OE ofertues duhet gjithashtu të paraqesin nga 1 (një) model (mostër) të prodhuar për këtë procedurë prokurimi sipas kërkesave të Specifikimeve teknike të kërkuara, për secilin nga artikujt objekt prokurimi pranë Autoritetit Kontraktor me adrese: Rr.Ibrahim Rugova ,Ish Garda e Republikës”, Tiranë. në datën dhe orën e hapjes së ofertave.

Mostrat e kërkuara më sipër, duhet të kenë një etiketë të qepur, e cila të përmbajë: mostër "emri i artikullit", datën e zhvillimit të tenderit, emrin e prodhuesit/ ofertuesit.

a) Mostrat fizike si këpucet të ndërtuar me lëndë të parë lëkure të jenë shoqëruar nga një pjesë 0,3X0,3cm lëkure në përputhje me specifikimet teknike të materialeve përbërëse të produktit dhe të shoqëruara me raporte testimi (Flete analizë) origjinale të lëshuar nga laboratorët të akredituar sipas standarteve kombëtare/ ndërkombëtare në fuqi që kanë kryer analizën për karakteristikat (treguesit) fiziko- mekanike- kimike te tyre.

Mosparaqitja e mostrave sipas kërkesave të mësipërme përbën kusht s'kualifikimi për vazhdimin e procedurave.

III.1.1.2 Në shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve teknike”, të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:


ILLYRIAN GUARD S.H.A.

Nr. 1028/15 Prot. Tiranë, më 16/06 /2023

Miratoi
Administratori


Robert DALLI

Specifikime Teknike – Tipi i kontratës - Mall


OBJEKTI I PROCEDURËS: “Këpucë me qafa”, lloji i procedurës e hapur

Baza Ligjore

- Ligji nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 36, e vijues
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar,
- Ligj nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”,
- Udhëzim e Ministrit të Brendshëm Nr. 130, datë 5.3.2018 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”,
- Udhëzim e Ministrit të Brendshëm Nr.496, datë 30 .07.2019 “Për një shtesë ne Udhëzim Nr. 130, datë 5.3.2018 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”
- Urdhëri Nr.1028/2 prot, datë 13 .06.2023 “Për Ngritjen e Komisionit për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën “Këpucë me qafa”,

Specifikimet kërkohen për “Këpucë me qafa”, që do të vishen nga punonjësit e IG, të cilët punojnë me tre turne, ne objekte me vendodhje të ndryshme (hidrocentrale, nenstacione, etj) dhe të ekspozuar në kushte atmosferike të ndryshme të temperaturura të ulta gjatë stinës së dimrit shi, borë, temperature të lartë në verë.

Komisioni propozoi Specifikimet të cilat vijojnë si më poshtë:


Këpucë me qafa

Ato duhet të prodhohen në masat 36-47 ose sipas nevojave të AK , masa do të dërgohet paraprakisht tek operatori fitues.

| | |
|-----------|--|
| | Lëkura |
| Lloji | Lëkure viçi ose ekuivalente natyrale |
| Ngjyra | E zezë |
| Trashësia | +/- 2 mm |
| | Foderimi- pjesa e brendshme |
| Ngjyrë | Neutral/ E zezë |
| Pesha | 260 gr/mq |
| Përbërje | 56% PA 34% PU 10% PES |
| | Foderimi i jashtëm përpara dhe pas |
| Ngjyrë | Gri/neutral |
| Pesha | 215 gr/mq |
| Përbërje | PA 72,5% + PE 27,5% |
| | Sholla e jashtme |
| Ngjyrë | E zezë |
| Përbërje | Poliuretan, termoplastike, gome ose ekuivalente |
| | Sholla e mesme |
| Veçori | E butë, me veti antistatike dhe përthithje të lartë. |
| Përbërje | Poliuretan ose të ngjashme në veti |
| | Sholla e lëvizshme |

| | |
|----------|--|
| Veçori | Termoformuar në feltro me fletë alumini të qepur fabrikisht me fill antistatik |
| Përbërje | viscolatex 46% + PES 36% + viskozë 18% - 1200g / mq |

| PARAMETRA KUSHTËZUES | |
|---|-----------------------------|
| Rezistencë ndaj grisjes e lëkurës | ≥ 120 N |
| Rezistencë ndaj tërheqjes e lëkurës | ≥ 15 N/mm ² |
| Depërtimi i ujit | $\geq 0,2$ gr |
| Përthithja e ujit | $\geq 30\%$ |
| Rezistenca ndaj shpimit | ≥ 1100 N |
| Përthithja e energjisë në zonën e thembrës | ≥ 20 J |
| Përmbajtja e kromit | ≤ 3 mg/kg |
| Depërtimi dhe thithja e ujit në pjesën e sipërme | ≥ 60 min. |
| Soliditeti i ngjyrës fodera | > 4 |
| Soliditeti ngjyrës ndaj djersës acide/alkaline/ujit fodera | > 4 |
| Rezistencë ndaj ujit fodera | 10.000 mm |
| Rezistenca e shollës ndaj vajrave dhe hidrokarbureve | $\leq 12\%$ |
| Rezistencë ndaj rrëshqitjes në bazë qeramike me ujë + lubrifikues larës | Min. 0.28 Min. 0.32 |
| Rezistencë ndaj rrëshqitjes në sfond çeliku me lubrifikant glicerinë | Min. 0.13 Min. 0.18 |

Këpucët përbëhen nga: Suprina; Pjesa fundore- sholla dhe Aksesorët

1. Suprina

Përbëhet nga këto pjesë: suprina; përfocuesi; copat anësore; veshja e brendshme (foderimi; mbështetëse e thembrës; maja).

Suprina, përforcuesi dhe copat anësore duhet të jenë prej lëkure viçi e plotë, e trashë, elastike 1.8- 2.0 mm.

Veshja e brendshme (foderimi) duhet të jetë me pëlhurë (të pathurur) 100% poliamide të certifikuar për përthithjen e djersës dhe që lejon qarkullimin e ajrit . Suprina duhet të jetë e bashkuar me copat anësore të lidhura në anën e pasme me qepje. Përforcuesi duhet të pozicionohet në pjesën e sipërme qendrore me anë të qepjes. Fodera e gjuhëzës duhet të jetë me pëlhure tridimensionale mesh.

Mbështetësi i thembrës duhet të jetë me lëkurë e të trajtuar e formuar me një trashësi prej rreth 1.8-2.0 mm e ngopur me rrëshirë natyrale ose sintetike, dhe duhet të aplikohet në pjesën e brendshme të pasme të këpucëve midis suprinës dhe foderës.

Maja duhet të jetë e përberë në pëlhurë pambuku ose përzierje pambuku-poliester, i ngopur me solucone të lëngshme polikloropreni ose lateksi natyral me një trashësi prej rreth 1.8-2.0 mm, dhe duhet të aplikohet në pjesën e përparme të brendshme të këpucëve midis suprinës dhe foderës.

Maja e përforcuar duhet të jetë në fibër xhami.

2. Pjesa e poshtme

Përbëhet nga: shtroja dhe sholla

Shtroja tek pjesa e përparme duhet të jetë prej lëkure dhe tek pjesa e pasme të jetë përbërë nga dy shtresa dhe me një fije çeliku brenda. Fija përforcuese metalike prej çeliku mund të zevendesohet për efekt komforti me poliuretan termoplastik, insert jo metalik me veti anti çpim me vlerë më të lartë se 0.

Gjithashtu duhet të jetë e markuar “Zero Perforation”.

Sholla duhet të jetë me material termoplastike elastike me veti anti-vjetrim, anti- vaj (rrëshqitje), anti-acid.

Pjesa e poshtme duhet të bashkohet me suprinën me anë të termosaldimit.

3. Aksesorët

Unazat 16 copë unaza bronzi në ngjyrën e këpucëve

Lidhëse të punuara me endje tubulare me 32 fije të zeza, poliesteri me gjatësi prej rreth 125 cm me skaje të përforcuar me një gjatësi jo më të vogël se 15 mm.

4. Montimi

Të gjitha pjesët duhet të bashkohen me injeksione direkte.

ETIKETA DHE PAKETIMI

Në pjesët e brendshme të këpucëve duhet vendosur një etiketë në të cilën ka shenjat e mëposhtme:

- Markatura CE
- Prodhuesi
- Kodi
- Standardet aderuese me simbolet përkatëse
- Data e prodhimit

Këpucët duhet të pakëtohen të çiftuara (djathtas dhe majtas të të njëjtit numër), për më tepër çdo këpucë nga jashtë, ka të dukshme:

- Përmasat
- Origjinën e produktit

Çdo palë të vendoset në një kuti kartoni të bërë me porosi me qëndrueshmëri, që këpucët të mos pësojnë deformime ose thyerje të rëndësishme gjatë operacioneve të stivimit dhe transportit. Secila kuti, e përbërë nga një trup dhe një kapak, të jetë e një madhësie të përshtatshme dhe të përmbajë në njërin anë të trupit indikacionet e mëposhtme:

- Emrin e modelit ose kodin
- Përmasat
- Emrin e furnizuesit

KUSHTE TË DOMOSDOSHME

Artikujt duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë, në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara në lidhje me sigurinë dhe veshjet mbrojtëse. Ato duhet të jenë konceptuar dhe prodhuar **minimalisht** për të mbrojtur konsumatorin nga rreziqet e mëposhtme që i përkasin kategorisë I (së parë) të normativës:

- Rreziqet që rrjedhin nga veprime dëmtuese të shkaktuara nga instrumentet mekanike;
- Fenomene të zakonshme të motit;
- Rreziqet që rrjedhin nga kontakti ose ndikimi me objektet e nxehta që nuk ekspozohen në temperatura që tejkalojnë 50 ° C.

Referuar kushteve në të cilat do të përdoren këpucet, dizenjimi dhe prodhimi i tyre të jetë konform Regullores EU EN 425/2016.

Argumentimi

Përbërja lekure

Vetitë e lëkurës varen nga origjina e lëndës së parë, mënyra sesi përgatitet lëkura e papërpunuar për t'u nënshtruar modifikimeve kimike, mënyra sesi kryhen këto modifikime kimikisht, mënyra sesi vajoset lëkura dhe në fund mënyra sesi përgatitet syprina.

Ruajtja - Ekspozimi

Temperatura

Konstantja e arsyeshme dhe e preferueshme 18-22 0 C, maksimumi 25 0 C. Konstantja e arsyeshme dhe e preferueshme 18-22 0 C, maksimumi 25 0 C.

Lageshtia Relative

45-55% 45-55%

Ndriçimi

Preferohet ruajtje në errësi, por në qoftë se drita është e pranishme ajo duhet të jetë 150 lux ose më pak. Nëse lëkura është e ngjyrosur ndriçimi duhet të jetë 50 lux ose më pak. Duhet të jetë 150 lux ose më pak. Nëse lëkura është e ngjyrosur ndriçimi duhet të jetë 50 lux ose më pak.

Përmbajtja e rrezeve UV të dritës

Preferohet ruajtje në errësi, por në qoftë se drita është e pranishme, përmbajtja e rrezeve UV duhet të jetë më pak se 30µë/lm dhe jo më shumë se 75µë/lm. Më pak se 30µ ë/lm, dhe jo më shumë se e veshesit.

Komisioni

III.1.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.1.4. Në nenin 3 Parime të përgjithshme: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën.

Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.1.5. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

III.1.1.6. Neni 77 pika 1 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

III.1.1.7. Në nenin 40 pika 6 germa a) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës,

me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

III.1.1.8. Në Ligjin Nr. 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”, Neni 23 *Uniforma e punonjësit të shërbimit të SHPSF-së*, parashikohet:

- 1. Uniforma e punonjësit të shërbimit të SHPSF-së mbahet dhe përdoret vetëm gjatë kryerjes së shërbimit.*
- 2. Në uniformë duhet të vendosen, sipas përkatësisë, shenjat dalluese, emblemat, stemat, numri identifikues, të cilat tregojnë identitetin e subjektit dhe të punonjësit të shërbimit.*
- 3. Uniforma dhe elementet përbërëse të saj nuk duhet të jenë të ngjashme me strukturat e Policisë së Shtetit, të Forcave të Armatosura dhe të agjencive të tjera ligjzbatuese shtetërore, të krijuara sipas legjislacionit në fuqi.*
- 4. Pjesët përbërëse të uniformës, paraqitja e jashtme e punonjësit të shërbimit, gjatë kryerjes së detyrës, mjetet sinjalizuese, pamore/zanore, vendosja dhe përdorimi i tyre përcaktohen me udhëzim të ministrit.*

III.1.1.9. Në Udhëzimin Nr. 130, datë 5.3.2018 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”,

KREU VII, “*Uniforma, Mjetet, Pajisjet E Shërbimit, Dokumenti I Identifikimit Të Punonjësit Të Shpsf-Së*” përcaktohet:

A. *Uniforma e shërbimit*

- 1. Uniforma e shërbimit dhe elementet përbërëse të saj janë të njëjta për të gjitha subjektet e shërbimit privat të sigurisë fizike.*
- 2. Uniforma e punonjësit të shërbimit privat të sigurisë fizike nuk duhet të jetë e njëjtë dhe e ngjashme me uniformën e strukturave të Policisë së Shtetit, Forcave të Armatosura dhe të agjencive të tjera ligjzbatuese shtetërore.*
- 3. Në uniformë të vendosen shenjat dalluese, emblemat, stema e subjektit dhe dokumenti identifikues i punonjësit të shërbimit privat të sigurisë fizike.*
- 4. Uniforma e punonjësit të shërbimit privat të sigurisë fizike mbahet dhe përdoret vetëm gjatë kryerjes së shërbimit.*
- 5. Punonjësit privat të sigurisë fizike, gjatë kryerjes së shërbimit, do të përdorin vetëm këto uniforma:*
 - uniforma shërbimi bazë;*
 - uniforma shërbimi operacionale;*
 - veshje civile.*
- 6. Uniforma e shërbimit bazë përdoret nga punonjësit e shërbimit të subjekteve të pajisur me licencë të nënkategorisë 1.3.A, për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve shtetërore dhe private dhe për sigurimin e veprimtarive social-kulturore sportive, fetare e politike.*
- 7. Uniforma e shërbimit operacionale përdoret nga punonjësit e shërbimit të subjekteve të pajisura me licencë të nënkategorisë 1.3.B, për ruajtjen dhe sigurimin e vlerave monetare, materialeve dhe sendeve të çmuara gjatë transportit.*

8. Veshja civile përdoret nga punonjësit e shërbimit të nënkategorisë 1.3.A për kryerjen e shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të personave (truproja).

9. Për nevoja shërbimi, punonjësit e subjekteve private të sigurisë fizike mund të përdorin uniformë shërbimi operacionale dhe veshje civile, sipas përcaktimeve në kontratën e lidhur ndërmjet palëve.

10. Uniforma e shërbimit bazë dhe uniforma e shërbimit operacionale e punonjësit të shërbimit privat të sigurisë fizike, të jetë ngjyrë kafe e errët, me kodin #C1608.

11. Elementet përbërëse të uniformës së shërbimit bazë janë:

- xhaketa;
- pantallona dimërore dhe verore që përdoren sipas stinëve;
- këmishë me mëngë të gjata dhe të shkurtra që përdoren sipas stinëve;
- kapelë;
- kravatë;
- pulovër me jakë në formën e germës "V";
- këpucë verore/dimërore;
- xhup sintetik.

12. Elementet përbërëse të uniformës së shërbimit operacionale janë:

- kostum doku (xhakëtë, pantallona);
- kapelë tip sport;
- bluzë me jakë të rrumbullakët, me mëngë të gjata e të shkurtra;
- bluzë pambuku, me 2 kopsa, me mëngë të shkurtra;
- këpucë me qafa (këmbale)
- xhup sintetik;
- rrip multifunksional.

13. Elementet përbërëse të veshjes civile janë:

- kostum civil (xhakëtë, pantallona);
- këmishë (mëngë të gjata e të shkurtra);
- këpucë;
- kravatë;
- xhup/pallto/pardesy.

14. Në krahun e majtë të uniformës së shërbimit bazë dhe asaj operacionale dhe në ballin e kapelës vendoset stema e subjektit të shërbimit privat të sigurisë fizike. Në gjoks dhe në krahun e majtë të uniformës të punonjësit të shërbimit vendoset numri identifikues për çdo subjekt të SHPSF-së, duke filluar nga 0001 dhe në vazhdim sipas numrave në regjistrin e subjektit.

15. Rrethi i kapelës të uniformës së punonjësit të shërbimit privat të sigurisë fizike është me ngjyrë të kuqe. Në pantallona, poshtë qemerit, në rafinën anësore, në gjatësinë e tyre, vendoset në mënyrë uniforme fileto tekstil ngjyrë të kuqe, me përmasa nga 8 deri 10 mm, me qepje të përforcuar.

16. Punonjësi i shërbimit privat të sigurisë fizike, gjatë kryerjes së shërbimit, duhet të ketë një paraqitje të jashtme dinjitoze dhe uniformë të rregullt (veshje civile).

III.1.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve

teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36, pika 1, paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksional sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira

në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”* Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet *“Specifikime teknike” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t’u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për praninë të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t’i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”*

Ndërsa, në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: *“specifikim teknik”* nënkupton njëherë nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Çëshjta C-368/10 “Komisioni European vs. Mberëtëria e Holandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: *“Specifikimet*

teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”

Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: "*specifikim teknik*" nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Cëshjta C-368/10 "Komisioni Europian vs. Mberëtëria e Hollandës" inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: "*Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”*

Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", të parashtrojnë pretendime mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se ligji 162/2020 "Për prokurimin publik" është përafshuar pjesërisht edhe me *Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 "Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike", e ndryshuar". Numri CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.395, datë 30.12.1989, fq. 33. Në dritën e direktivës, ekzistojnë dy kushte të përmendura në lidhje me qasjen në procedurat e rishikimit (neni 1 (3): "Procedurat e rishikimit duhet të jenë në dispozicion (...) të paktën për çdo person që ka ose ka pasur interes për të marrë një kontratë të veçantë dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar". Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës referuar parimit juridik *onus probandi incubit actor* (barra e provës i bie kërkuarit), si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", në të cilin parashikohet se: "*në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*". Pra, operatorët ekonomikë duhet të*

argumentojnë/dëshmojnë, se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe jo mbi faktin se këto të fundit nuk plotësohen nga një ose disa prodhues kombëtar/ndërkombëtar me reputacion. Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, nënvizon, se autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike të procedurës së prokurimit duhet t'i përmbahet *stricto-sensu* vetëm metodave të parashikuara në nenin 36 të ligjit për prokurimin publik. Ato duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Komisioni gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma "dh", se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.1.1.11. Në përputhje me nenin 24 pika 3 të ligjit nr.162/2020 "*Për prokurimin publik*", ku parashikohet se: "*Në marrjen e vendimeve mban parasysh, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit.*", Komisioni, në jurisprudencën e tij, e ka bërë pjesë të standardeve për një proces të rregullt ligjor edhe respektimin e parimit të kontradiktoritetit. Për sa më sipër, *parimi i kontradiktoritetit*, i parë në këndvështrimin e barazisë së armëve në procesin administrativ, është një evolucion logjik i të drejtës së palës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t'u trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nga një gjyqtar (arbitër) i drejtë dhe i paanshëm, i cili u garanton të dyja palëve të njëjtat mundësi, për të shpalosur provat dhe argumentet e tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në shqyrtimin administrativ, atëherë argumentet e njërës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar, dhe për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues, dhe ligjor për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Ndaj për këtë qëllim, Komisioni organizoi një seancë dëgjimore mes palëve në lidhje me arsyet e skualifikimit dhe përmbushjen e specifikimeve teknike nga ana e operatorit ekonomik ankimues. Gjatë seancës në pyetjet drejtuar autoritetit kontraktor, Komisioni gjykoi të sqarimin mbi metodën e ndërtimit të specifikimeve teknike, por edhe në drejtim të rolit në funksionalitetin e produktit prej specifikimeve teknike të cilat pretendohet se nuk janë përmbushur nga ankimuesi. Gjithashtu, për ankuesin u drejtuan pyetje në drejtim të provueshmërisë së faktit, të përmbushjes specifikimeve teknike dhe arritjes së qëllimit të autoritetit kontraktor.

III.1.1.12. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike,

reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.1.13. Referuar dokumentacionit dhe materialeve bashkëlidhur, të dorëzuara nga autoriteti kontraktor pranë Komisionin e Prokurimit Publik, konstatohet, se janë paraqitur mostrat e dorëzuara nga operatori ekonomik "Armand Sinani" PF pranë autoritetit kontraktor.

III.1.1.14. Referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit rezulton, se është kërkuar shprehimisht që ofertuesi duhet të paraqesë si pjesë të ofertës teknike *1 (një) model (mostër) të prodhuar për këtë procedurë prokurimi sipas kërkesave të Specifikimeve teknike të kërkuara*, mungesa e të cilit është kusht skualifikues. Gjithashtu, në shtojcën për specifikimet teknike, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kërkesat e specifikimeve teknike që duhet të plotësojë ky artikull.

III.1.2. Operatori ekonomik ankimues në ankesën e tij pretendon se *"Në rastin konkret, pasi morëm në shqyrtim dokumentet standarte të tenderit, si dhe specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt ankimi, konstatojmë se në asnjë specifikim nuk është përcaktuar as ngjyra e penjve dhe asnjë specifikë konkrete mbi përbërjen, fortësinë dhe çdo specifikë tjetër që duhet të kenë penjtë. [...] Në lidhje me këtë argumentim të AK kërkojmë të theksojmë se nëse marrim në shqyrtim specifikimet teknike të procedurës objekt ankimi konstatojmë se autoriteti kontraktor për të ilustruar modelin e këpucës ka paraqitur nje foto e cila është bardh e zi dhe rrjedhimisht nuk tregon ngjyrën e asnjërit prej përbërësve të këpucës dhe mbi të gjitha nuk është një foto e qartë pasi nuk tregon pjesën e mbrapme por thjesht një foto ilustruese."*

III.1.2.1. Në seancën dëgjimore të zhvilluar në mjediset e KPP-së më datë 18.12.2023 lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Armand Sinani" PF, për skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit me pretendimin se *"Këpucët janë qepur me fill në ngjyrë të kuqe, ndërkohë që kërkesa e klientit është që këpuca duhet të jetë me ngjyrë të zezë. Kjo gjë nuk përputhet me modelin e paraqitur në foto dhe shprehur me fjalë në kërkesat e specifikimeve teknike ku shprehet se ngjyra e këpucës të jetë e zezë."*, Komisioni iu drejtua autoritetit kontraktor me pyetjet se *"Cilat janë specifikimet teknike të kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor në lidhje me ngjyrën e fijeve? Cili është qëllimi i vendosjes së këtij specifikimi dhe a ka një vendim unifikues mbi elementët e paraqitjes së uniformës? Në cilin*

seksion të specifikimeve teknike gjendet kërkesa që filli i qepjes duhet të jetë në ngjyrë të zezq Pyetjeve të Komisionit autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur i është përgjigjur se: “Shoqëria Illyrian Guard funksionin në bazë të ligjit për SHPSF 75/2015, ku në bazë të ligjit dhe udhëzimit ka një uniformë të posaçme, ashtu si edhe këpucët, janë miratuar dhe nuk mund të dalim jashtë këtyre specifikimeve pasi duhet të pajisim të gjithë punonjësit e shërbimit pasi këpuca duhet të jetë e njëjtë me këpucën aktuale. [...] Nuk është thënë në mënyrë specifike ngjyra e fillit të qepjes, por vetëm që ngjyra e këpucës të jetë e zezë dhe modeli i këpucës të jetë i njëjtë me këpucët aktuale.”

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, i është drejtuar autoritetit kontraktor me pyetjen nëse këpucët aktuale që përdor shoqëria Illyrian Guard sha i janë bërë të ditura operatorëve ekonomikë në dokumentat e tenderit. Autoriteti kontraktor është përgjigjur se nuk ka patur kërkesa për sqarime nga operatorët ekonomikë. Është publikuar modeli i këpucës dhe nuk është thënë që tegelat nuk duhet të jenë të kuq.

Operatori ekonomik në seancë, në lidhje me këtë pretendim, sqaron se ka realizuar këpucën sipas fotos dhe specifikimeve teknike të pasqyruar nga autoriteti kontraktor. Tegelat e kuq, janë bërë për shkak se sipas praktikës mostrat paraqiten me tegela me ngjyrë për të treguar cilesinë e qepjes së tegelit. Nuk është specifikuar që kampioni duhet të jetë me pe të zi. Gjithshtu OE sqaron se në këtë procedurë është në cilësinë e distributorit të autorizuar.

III.1.2.2. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, argumentimi i autoritetit kontraktor, si dhe shqyrtimi i specifikimeve teknike dhe procesverbalit të argumentimit të tyre nga ana e autoritetit kontraktor, konstatohet, se në asnjë pjesë të specifikimeve teknike nuk është përcaktuar ngjyra e fijes për qepjen, fakt ky i pranuar dhe nga vetë autoriteti kontraktor gjatë seancës dëgjimore.

Autoriteti kontraktor në procesverbalin e specifikimeve teknike, përcakton se “Në datën 15.06.2023 në mbledhjen e radhës komisioni vendosi të propozojë që modeli i këpucëve me qafa të jetë i njëjtë me këpucët aktuale të shoqërisë”. Nisur nga kjo, nga verifikimi i specifikimeve teknike, konstatohet se është pasqyruar vetëm një skicë bardhë e zi, në të cilën nuk është e mundur verifikimi i ngjyrës, apo modelit të tegelave.

Sa më sipër, KPP gjykon se, referuar argumentimit të autoritetit kontraktor si dhe përcaktimit të kriterit se “Në datën 15.06.2023 në mbledhjen e radhës komisioni vendosi të propozojë që modeli i këpucëve me qafa të jetë i njëjtë me këpucët aktuale të shoqërisë.”, KPP gjykon se, referuar kërkesave të vetë autoritetit kontraktor, me qëllim që ky i fundit të sigurojë furnizimin me këpucë të të njëjtit model që disponon, duhej që të publikonte në mënyrë sa më të qartë dhe të evidentueshme për operatorët ekonomikë, modelin aktual të këpucës. Skica e publikuar nga autoriteti kontraktor nuk është e qartë vizualisht, në mënyrë që ofertuesit të prodhojnë identik të njëjtin model të mëparshëm që disponon autoriteti kontraktor.

Vlen të theksojmë, se operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, dhe vlerësimi nga ana e autoritetit kontraktor duhet të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Sa më sipër, për sa kohë në specifikimet teknike nuk përcaktohet ngjyra e fijes së qepjes së tegelit, rrjedhimisht autoriteti kontraktor nuk duhet të vlerësojë mbi kërkesa të cilat nuk janë kërkuar nga ana e tij.

III.1.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Armand Sinani” PF se arsyeja e skualifikimit “2.Mbërthimi dhe lirimi i këpucës është realizuar me zinxhirë në pjesën e përparme të këpucës, ndërkohë që në kërkesat e specifikimeve teknike është kërkuar të jetë me lidhëse. Kjo gjë jo vetëm është në kundërshtim me kërkesat e specifikimeve teknike të kërkuara, por ky fakt sjell një devijim të uniformës, pasi do të kishim dy lloje modelesh në përdorim deri në kalimin e gjithë personelit në këpucën e re, për shkak edhe të afatit të përdorimit të tyre, i cili është i ndryshëm dhe i lidhur me afatin e vënies në përdorim të këpucëve ekzistuese nga përdoruesit. Kërkesa e specifikimeve teknike citon në pikën 3 të saj se: “këpuca duhet të ketë 16 unaza bronzi në ngjyrën e këpucës dhe lidhese të zezë rreth 125 cm”, dhe specifikon mbërthimin e këpucës me lidhëse”, nuk qëndron, si dhe arsyeja e skualifikimit se Në specifikimet teknike është kërkuar që këpuca të ketë 16 unaza bronzi në të dy anët e saj për të siguruar lidhjen e saj ndërkohë që këpuca mostër e paraqitur ka gjithsej 36 unaza bronzi të vendosura në 4 rrjeshta në vrimat e hapura për lidhje”, KPP vëren se:

Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i specifikimeve teknike konstaton, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se “3. Aksesorët – Unazat 16 copë unaza bronzi në ngjyrën e këpucëve. Lidhëse të punuara me endje tubulare me 32 fije të zeza, poliesteri me gjatësi prej rreth 125 cm me skaje të përforcuar me një jetëgjatësi jo më të vogël se 15 mm.”

III.1.3.1. Operatori ekonomik ankimues në ankesën e tij pretendon se “Së pari, konstatojmë se autoriteti ka vepruar me 2 standarte në vlerësimin e mostrave të dorëzuara, pasi nga njëra anë në pretendimin e mësipërm ka argumentuar se ngjyra e penjve nuk është zezë dhe këtë pretendim e argumenton bazuar në një foto ilustruese bardh e zi ku nuk mund të kuptohet ngjyra e penjve dhe nga ana tjetër skualifikon ofertën tonë me pretendimin se “Mbërthimi dhe lirimi i këpucës është realizuar me zinxhirë në pjesën e përparme të këpucës” ndërkohë që në foton ilustruese vërehet qartësisht se modeli në foto është me zinxhirë në pjesën e përparme të këpucës. [...] Ne rastin konkret, se pari kerkojme te sqarojme autoritetin kontraktor se ashtu si arsyetuar më sipër ne mostrat e dorëzuara nga "Armand Sinani" P.F këpuca ka edhe nje aksesor shtes si zinxhiri në pjesën e përparme te kepuces, aksesor i cili vendoset ne kepuce per arsye sigurie por gjithesesi mund te hiqet ose te vendoset në çdo moment në varesi te deshires se perdoruesit te këpucës. Rrjedhimisht meqënëse kemi këte aksesor shtese, nuk kemi 2 rrjeshta unaza bronxi por kemi 4 rrjeshta unaza bronxi por nëse autoriteti kontraktor vendos qe mos te perdore zinxhirin ne pjesen e përparme te këpuces por te perdore vetem lidhset rrjedhimisht dhe numri i unazave te bronxit do te pergjysmohet nga 36 në 18.

Akoma më tej, ne lidhje me faktin se autoriteti kontraktor ka kerkuar qe kepuca te kete 16 unaza bronxi kerkojme te sqarojme autoritetin kontraktor se numri i unazave te bronxit nuk mund te jete i njejte si për këpucën me numer 36, si per këpucën me numer 47 por numri i unazave te bronxit ndryshon ne varesi te numrit te këpuces pasi lidhet me momentin e zhvillimit te numeracionit te modelit te kepuces. Me konkretisht për kepuce me numer 42 e cila shte kepuca e dorëzuar ne cilesine e mostres nëse AK do te perdor këpuce me lidhese dhe jo me zinxhire do te kemi 18 unaza bronxi ndersa per kepuce psh me numer 38 do te kemi 16 unaza bronxi. Per vertetimin e këtij fakti ne praktike jemi te gatshem në çdo moment te vendosim ne dispozicion te autoritetit kontraktor dhe/ose te Komisionit te Prokurimit Publik te njejten model

köpuce por me numer 38 ne mënyre te tille qe te vertetohet ky fakt jo vetem teknikisht por edhe praktikisht. Gjithashtu kerkojme te theksojme se referuar fotos ilustruese te paraqitur ne dokumentat standarte te tenderit nga autoriteti kontraktor verehet se numri i unazave te bronzit te kepuces se paraqitur ne foto është e njejte me numin e unazave te bronzit që ka këpuca e dorezuar ne cilesine e mostres.”

III.1.3.2. Në seancën dëgjimore të zhvilluar në mjediset e KPP-së me datë 18.12.2023 lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Armand Sinani” PF, për skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit me pretendimin se *“2.Mbërthimi dhe lirimi i këpucës është realizuar me zinxhirë në pjesën e përparme të këpucës, ndërkohë që në kërkesat e specifikimeve teknike është kërkuar të jetë me lidhëse. Kjo gjë jo vetëm është në kundërshtim me kërkesat e specifikimeve teknike të kërkuara, por ky fakt sjell një devijim të uniformës, pasi do të kishim dy lloje modelesh në përdorim deri në kalimin e gjithë personelit në këpucën e re, për shkak edhe të afatit të përdorimit të tyre, i cili është i ndryshëm dhe i lidhur me afatin e vënies në përdorim të këpucëve ekzistuese nga përdoruesit. Kërkesa e specifikimeve teknike citon në pikën 3 të saj se: “këpuca duhet të ketë 16 unaza bronzi në ngjyrën e këpucës dhe lidhëse të zezë rreth 125 cm”, dhe specifikon mbërthimin e këpucës me lidhëse”* si dhe arsyeja e skualifikimit se *“Në specifikimet teknike është kërkuar që këpuca të ketë 16 unaza bronzi në të dy anët e saj për të siguruar lidhjen e saj ndërkohë që këpuca mostër e paraqitur ka gjithsej 36 unaza bronzi të vendosura në 4 rreshta në vrimat e hapura për lidhje”,* operatori ekonomik argumenton, se zinxhiri është lehtësisht i heqshëm nga këpuca, duke e demonstruar këtë fakt edhe në prani të palëve në seancën dëgjimore. Gjithashtu, si rrjedhojë operatori ekonomik deklaron, se më heqjen e zinxhirit ulet dhe numri i unazave nga 36 në 18. Operatori ekonomik deklaron, se mund të realizojë modelin e këpucës pa zinxhir, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Operatori ekonomik në seancën dëgjimore deklaron, se numri i unazave është në varësi të numrit të këpucës, një numër më i madh këpuce ka një numër më të lartë unazash.

Ndërkohë, autoriteti kontraktor në seancën dëgjimore deklaron, se lidhëset janë sipas specifikimeve teknike, por prania e mbërthimit me zinxhir dhe numri më i lartë i unazave nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor në specifikimet teknike. Gjithashtu, autoriteti kontraktor gjatë seancës dëgjimore deklaron, se të gjitha këpucët pavarësisht numrit të tyre duhet të kenë të njëjtin numër unazash, gjithashtu me heqjen e zinxhirit hapësira e mbetur midis dy anëve është tepër e madhe dhe joestetike.

Sa më sipër, KPP nga verifikimi i të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe nga argumentimet e të dyja palëve gjatë seancës dëgjimore, konstaton, se, në specifikimet teknike nuk përcaktohet se këpuca duhet të jetë me zinxhir, por gjithashtu nga demonstrimi i operatorit ekonomik gjatë seancës dëgjimore, u konstatua se zinxhiri mund të hiqej lehtësisht dhe rrjedhimisht me heqjen e tij ulet dhe numri i unazave në 18. Gjithashtu, ashtu siç vetë autoriteti kontraktor gjatë seancës dëgjimore deklaron heqja e zinxhirit nuk ndikon në funksionalitetin e këpucës, por në pamjen estetike të saj, pasi hapësira që mbetet midis dy anëve është shumë e madhe. Ndërkohë që, gjykojmë se lidhur me këtë pretendim të autoritetit kontraktor, nga verifikimi i specifikimeve teknike, nuk parashikohet se sa duhet të jetë kjo hapësirë. Gjithashtu, lidhur me numrin e

unazave, KPP gjykon se autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar në kriteret e kualifikimit, si dhe në specifikimet teknike se sa duhet të jetë numri i këpucës, i cili duhet të paraqitet si mostër për verifikim, në mënyrë që të përlllogaritet numri i unazave sipas pretendimeve të ankimuesit. Gjithashtu, nga vetë autoriteti kontraktor nuk argumentohet në asnjë moment se si numri i unazave ndikon në funksionalitetin e këpucës.

Autoriteti kontraktor, si gjatë seancës dëgjimore, ashtu edhe në kriteret dhe specifikime teknike kërkon të prokurojë të njëjtin model këpuce të mëparshme që ka aktualisht në përdorim, por në asnjë moment nuk argumenton se ky është një model i mbështetur në standarde kombëtare, apo në një vendim të unifikuar, ku të parashikohet saktësisht modeli i këpucëve që duhet të përdoren.

Nga verifikimi i dokumentacionit të autoritetit kontraktor, konstatohet, se specifikimet teknike janë miratuar nga komisioni për hartimin e specifikimeve teknike me vendimin nr.1028/4 prot., datë 16.06.2023, por në asnjë moment nuk argumentohet se ku janë mbështetur për vendosjen posaçërisht të këtij modeli këpucës apo specifikimesh. Autoriteti kontraktor i referohet modelit aktual që disponon dhe përdor, por në asnjë moment nuk ka pasqyruar në specifikimet teknike modelin aktual, i cili duhet të bëhet i njohur për të gjithë operatorët ekonomikë të cilët kanë shfaqur interes për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi.

Akoma më tej theksojmë, se mostra është një model, i cili i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar bindjen se operatori ekonomik ka kapacitetin për realizimin e objektit të prokurimit me cilësi dhe sipas të gjitha specifikimeve teknike.

III.1.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Armand Sinani” PF se arsyeja e skualifikimit “4. Në pjesën e pasme këpuca mostër ka 6 tegele zbukurimi me penj të kuq, ndërkohë që në specifikimet teknike nuk ka asnjë tegel zbukurues përveç tegelit të qepjes së thembrës, duke u shmangur krejtësisht nga modeli i paraqitur në specifikime.”, KPP vëren se:

III.1.4.1. Operatori ekonomik ankimues në ankesën e tij pretendon se “Se katerti, ne lidhje me skualifikimin e ofertes sone me pretendimin se “Ne pjesën e pasme këpuca mostër ka 6 tegele zbukurimi me penj te kuq, nderkohe qe ne specifikimet teknike nuk ka asnje tegel zbukurues pervec tegelit te qepjes se thembres, duke u shmangur krejtësisht nga modeli i paraqitur ne specifikime.”, vlersojme se eshte nje pretendim i pabazuar ne ligj dhe ne fakt dhe si i tille nuk qendron.” Ne rastin konkret pasi morem në shqyrtim specifikimet teknike te procedures se prokurimit kerkojme te sqarojme se autoriteti kontraktor nuk ka percaktuar në specifikimet teknike nëse kepuca duhet te kete tegele zbukurimi ose jo, por jo vetem kaq por dhe ne foton ilustruese qe ka paraqitur nuk ka nxjerrë pjesën e pasme te këpuces ku te kuptohet nëse këpuca duhet te kete tegele ose jo. Per kete arsye, vleresojme se autoriteti kontraktor nuk mund te skualifikoje nje operator ekonomik per nje kerkese te paspecifikuar, por duhet te vleresoje operatorit ekonomike piesemarrës vetem duke u bazuar në specifikimet teknike te parashikuara shprehimisht, bazuar në te cilat percaktohen te dhenat që duhet te kete lenda e pare që nevojitet per prodhimin e këpuces.”

III.1.4.2. Në seancën dëgjimore të zhvilluar në mjediset e KPP-së më datë 18.12.2023, lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Armand Sinani” PF, për skualifikimin e

ofertës së tij nga procedura e prokurimit me arsyetimin e mësipërm, deklarën se autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, nuk ka përcaktuar nëse duhet të këtë tegela apo jo. Gjithashtu, në skicën e paraqitur si model nuk është e dukshme pjesa mbrapa e këpucës, që të mund të evidentohet pamja e saj. Gjithashtu, operatori ekonomik ankimes gjatë seancës deklarën se nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për sqarim, pasi nuk ka patur paqartësi. Gjatë seancës, operatori ekonomik deklarën se mund të realizojë modelin e këpucës sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Ndërkohë, autoriteti kontraktor në seancën dëgjimore deklarën, se në specifikimet teknike nuk ka parashikuar tegela shtesë në pjesën mbrapa të këpucës.

Sa më sipër, KPP nga verifikimi i të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe nga argumentimet e të dyja palëve gjatë seancës dëgjimore, konstatojnë, se në specifikimet teknike nuk përcaktohet prania e tegelave ose jo në këpucë.

Autoriteti kontraktor, si gjatë seancës dëgjimore, ashtu edhe në kriteret dhe specifikimet teknike deklarën, se kërkon të prokurojë të njëjtin model këpuce të mëparshme që ka aktualisht në përdorim, por në asnjë moment nuk argumenton se ky është një model i mbështetur në standarde kombëtare, apo në një vendim të unifikuar, ku të parashikohet saktësisht modeli i këpucëve që duhet të përdoren.

Nga verifikimi i dokumentacionit të autoritetit kontraktor, konstatohet, se specifikimet teknike janë miraturar nga komisioni për hartimin e specifikimeve teknike me vendimin nr.1028/4 prot., datë 16.06.2023, por në asnjë moment nuk argumentohet se ku janë mbështetur për vendosjen posaçërisht të këtij modeli këpucës apo specifikimesh. Autoriteti kontraktor i referohet modelit aktual që disponon dhe përdor, por në asnjë moment nuk ka pasqyruar në specifikimet teknike modelin aktual, i cili duhet të bëhet i njohur për të gjithë operatorët ekonomikë të cilët kanë shfaqur interes për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi.

Akoma më tej theksojmë, se mostra është një model, i cili i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar bindjen se operatori ekonomik ka kapacitetin për realizimin e objektit të prokurimit me cilësi dhe sipas të gjitha specifikimeve teknike.

III.1.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Armand Sinani” PF, se arsyeja e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike “5. *Këpuca nga provat praktike të kryera me disa përdorues rezultojnë të jetë shumë statike dhe jo e përshtatshme për lëvizje të lirshme dhe të shpejta, këto në funksion të situatave operacionale që shoqëria jonë duhet të kryejë, si dhe mbajtjen për një kohë të gjatë të tyre në shërbim.*”

III.1.5.1. Operatori ekonomik ankimes në ankesën e tij pretendon, se “*Se pesti, në lidhje me skualifikimin e ofertës sone me pretendimin se "Këpuca nga provat praktike të kryera me disa përdorues rezultojnë të jetë shumë statike dhe jo e përshtatshme për lëvizje të lirshme dhe të shpejta, këto në funksion të situatave operacionale që shoqëria jonë duhet të kryejë, si dhe mbajtjen për një kohë të gjatë të tyre në shërbim."*, vlerësojmë që jo vetëm që është e pabazuar në ligj dhe në fakt por gjithashtu është një pretendim teresisht i paargumentuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin konkret, gjykojmë se autoriteti kontraktor duhet të vlerësojë ofertat e operatoreve ekonomike vetëm për përmbushjen e kriterëve/ kërkesave apo specifikimeve teknike të parashikuara në dokumentat standarte të tenderit dhe nuk mund të skualifikojë

kurresesi nje operatore ekonomik nga nje mendim subjektiv i perdoruesve te ndryshem te këpucëve. Permbushja ose jo e specifikimeve teknike nga operatorit ekonomike percaktohet nga test raportet që operatorët ekonomike kryejne per mallrat objekt prokurimi dhe jo nga nje menim subjektiv i personave te ndryshem.”

III.1.5.2. Në seancën dëgjimore të zhvilluar në mjediset e KPP-së me datë 18.12.2023 lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Armand Sinani” PF, për skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit me pretendimin, se *“Këpuca nga provat praktike të kryera me disa përdorues rezulton të jetë shumë statike dhe jo e përshtatshme për lëvizje të lirshme dhe të shpejta, këto në funksion të situatave operacionale që shoqëria jonë duhet të kryejë, si dhe mbajtjen për një kohë të gjatë të tyre në shërbim.”*, autoriteti kontraktor deklaroi se ka kryer testimin e dy mostrave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, tek punonjësit e shoqërisë “Illyrian Guard” SHA, se cila nga këpucët e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës është më komode.

Gjithashtu, autoriteti kontraktor në seancën dëgjimore deklaroi, se për këtë ka përgatitur disa fletë në formë pyetësoje të cilët janë plotësuar nga punonjësit të cilët kanë testuar mostrat, të cilët kanë konstatuar se është një këpucë shumë statike dhe e rëndë, jo e përshtatshme për qëllimin që kërkon autoriteti kontraktor.

Sa më sipër, referuar arsyes së skualifikimit, pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, si dhe argumentimit dhe deklaratimeve të autoritetit kontraktor, KPP gjykon, se lidhur me faktin që autoriteti kontraktor ka kryer teste të këpucës, konstatohet se në asnjë pikë të kriterëve të kualifikimit apo specifikimeve teknike të përcaktohet se mostrat do të testohen.

Gjithashtu, mbështetur në deklaratimet e autoritetit kontraktor në seancë, se ka kryer teste tek punonjësit, KPP, referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP-së, konstaton se nuk është paraqitur asnjë dokument i cili provon kryerjen e këtij testimi. Gjithashtu, KPP gjykon, se nga ana e autoritetit kontraktor nuk provohet se është ndjekur një procedurë ligjore në lidhje me kryerjen e testimit. Konkretisht nga ana e tyre nuk janë njoftuar palët në proces (operatorët ekonomikë) për të qenë prezent në procesin e testimit të mostrave të tyre, çka vërteton se mostrat janë administruar pa praninë e palëve në këtë proces. Në përfundim, sa më sipër argumentuar, gjykojmë, se për sa kohë, procesi i testimit të mostrave nga ana e autoritetit kontraktor nuk është kryer i saktë dhe nuk vërtetohet dhe dokumentohet nga ana e tij kryerja e këtij procesi, rrjedhimisht arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues nuk është e vlefshme.

III.1.6. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues për asyet më sipër, se mostra e paraqitur nuk është sipas specifikimeve teknike, nuk është i drejtë. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se në bazë të nenit 124 *“Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës”* të LPP, si dhe nenit 36 *“Sigurimi i kontratës”*, dhe nenit 108 *“Raportimi në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale”* të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallit do të jetë e njëjtë me cilësinë e

premtuar në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penaltitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të ligjit dhe rregullave për prokurimin publik, si më sipër cituar.

III.2. Me shkresën nr. 1028/64 prot, datë 17.11.2023 me objekt: *“Dërgim vendimi mbi ankesën nr.2773/2023 prot., datë 09.11.2023, prot me tonën nr. 1028/59 datë 09.11.2023, paraqitur nga OE “Armand Sinani”, protokolluar me tonën me nr. 2773/4 datë 21.11.2023, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Armand Sinani” PF, ku konstatohet se ankesa e këtij të fundit është refuzuar. Gjithashtu, konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka shtuar gjithashtu: “Krahas sa me sipër, KSHA ka evidentuar edhe faktin se KVO duke qene se kishte paqartesi në lidhje me dokumentin e paraqitur ne funksion te plotesimit te kerkeses per kualifikim, sipas pikes 2, te Kapacitetit Teknik 2.3 te Kriterëve te Veçanta te Kualifikimit, te percaktuara ne DT. Konkretisht behet fjale për dokumentin e paraqitur nga OE Armand Sinani si marreveshje Bashkëpunimi me "CALZATURIFICIO 5 BI SR", pasi dokumenti me nr 7/1 si dhe dokumenti 7/2 te ngarkuar ne SPE nuk kishin lexueshmeri te qarte te vulave te noterizimit si dhe në dokumentin 7/2 nuk kishte fare dokument noterizimi. Komisioni u vu ne vështiresi te vendimmarrjes per këte operator. Gjithsesi meqenese pjesemarrës ne tender ishin vetem dy OE dhe per te mos e perjashtuar nga pjesëmarrja ne tender OE Armand Sinani, komisioni vendosi që ti kerkoje te ngarkoje ne sistem dokumentacionin e kerkuar me qartesi me te mire te fotove te ngarkuara. Nga ana e tij OE Armand Sinani beri noterizim te ri te dokumentave te dyshuar 7/1 dhe dokumentit te pa noterizuar fare qe mbante numërin 7/2. Ne te njejten logjike per sqarimin e problemit KVO ju drejtua me email prodhuesit "CALZATURIFICIO 5 BI SR", per te sqaruar nese dokumenti i paraqitur nga OE Armand Sinani ishte autentik ose jo. Kaloi nje periudhe pritje qe ishte me teper se nje jave ku KVO nëpermjet edhe 2 e-maileve te tjera i ka kerkuar pergjigje "CALZATURIFICIO 5 BI SR" per dokumentin e paraqitur nga OE Armand Sinani. Meqenese pergjigja u vonua dhe procedura duhej mbyllur, KVO ka vendosur që te mbylle çështjet e dokumentacionit duke e kualifikuar OE Armand Sinani ne dokumentat e tenderit. Gjithsesi edhe pse me vonese ne dt. 2 Nëntor 2023, nderkohe qe ishte mbyllur raportimi ne SPE, erdhi pergjigja nga kompania Italiane "CALZATURIFICIO 5 BI SR" e pretenduar si bashkepunuese me OE Armand Sinani. Në këte pergjigje nuk jepej asnje e dhene per ate qe KVO kishte kerkuar, vertetesine e dokumentit "marreveshje bashkëpunimi" por thjesht jepej pergjie se "Z. Armand Sinani shte nje nga klientet/distributort tane ne Shqiperi. Per cdo informacion tjeter ju lutemi kontaktoni ate. Kjo pergjigje e ardhur ne ditën e enjte, 2 Nëntor 2023 12:26:19 PM +01,00 nuk tregon se dokumenti i paraqitur si marveshje bashkepunimi per te cilin shte insistuar te merrej pergjigje nga kompania Italiane "CALZATURIFICIO 5 BI SR, ishte dokumenti autentik qe Z. Armand Sinani e ka paraqitur ne Dokumentat e Tenderit (shih e-mailet bashkelidhur). Per më tepër marveshja e bashkëpunimit me operatore te tjere kerkon nëse prodhuesi merr persiper specifikisht te prodhoje mallin objekt prokurimi me numerin specifik te REF, me objekt "Kepece me qafa", REF-77994- 08-21-2023. Veç t tjerash ne marveshjen e bashkepunimit duhet te percaktohet nëse prodhuesi i pergjigjet specifikimeve teknike te percaktuara dhe sasise se percaktuar ne tender. Marveshja e paraqitur nuk e permbush këte kerkese. E githa sa më*

lart shte nje mungese e madhe per garancine dhe sigurine e prodhimit te kerkuar per Shogeria ILLYRIAN GUARD SHA. Marveshje ne fjale me titullin "Autorizim Prodhuesi" e dt 24.07.2023, e ngarkuar ne sistem me numërin 7/1, thuhet se "nëpermjet se ciles garantojme furnizimin e subjektit "Armand Sinani", person fizik me mallra per te cilat shogeria jone CALZATURIFICIOSBI" shpk, shfaqet ne cilesine e prodhuesit, si dhe te tregëtoje produktet tona në marëdhënie me institucionet private dhe publike ne teritorin e Republikes së Shiperise." Këtu shte momenti te theksojme se ky OE shte perjashtuar njëhere ne dt 07.02.2023 nga Pjesëmarrja në tender me Nr.Reference REF-55499-12-29-2022, për shkak se ka paraqitur të njëjtët këpucë që ka paraqitur edhe në tenderin në fjalë. Këpucët e paraqitura nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara dhe nuk përmbushin kërkesat tona."

Pra Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ka trajtuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi arsyet e skualifikimit, por ka zgjeruar interpretimin e tij, duke dhënë arsye të reja skualifikimi për operatorin ekonomik ankimues, në tejkalim të kompetencave të tij, arsye skualifikimi për të cilat ankimuesi nuk ka dijeni.

III.2.1. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim sistematik (domethënie e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit gjykon, se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale, atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor (rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh.A (Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave).

Normativa e parashikuar nga nenet 110 dhe 111 të ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimitimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së. Procedura para autoritetit kontraktor si edhe para KPP ka natyrën e procedurave të nxitura, pasi autoriteti kontraktor nuk mund të bëhet vetiniciator i fillimit të procedurave kryesisht. Si rregull, investimi i K.Sh.A është i bazuar (faktikisht i kufizuar) nga ankimet e sjella pranë saj vetëm nga subjekte të legjitimuara.

Sa më sipër, KPP gjykon, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka dalë jashtë tagreve dhe kompetencave të dhëna nga ligji dhe se KPP nuk mund të gjykojë mbi arsye për skualifikimin

e ofertës ngritur nga autoriteti kontraktor në momentin e shqyrtimit administrativ të ankesës së dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues.

Komisioni gjykon, se arsyet shtesë të parashtruara nga KSHA, janë në kundërshtim të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, ndaj këto arsye nuk sjellin asnjë pasojë mbi operatorin ekonomik ankimues, e si të tilla nuk merren në shqyrtim nga KPP.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Armand Sinani” PF mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Vojsava Zeneli” PF, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka ofertuar me vlerë më të ulët kundrejt operatorit ekonomik për të cilin paraqet pretendime për kualifikim, duke mos pasur një interes të ligjshëm të ankohet për operatorë të renditur sipër tij, referuar vlerës ekonomike.

Akoma më tej, referuar shqyrtimit të mësipërm të KPP, operatori “Armand Sinani” PF, do të kualifikohet, duke arritur kështu qëllimin e tij të ligjshëm, që është fitimi i kontratës.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik “Armand Sinani” PF, mbi operatorin ekonomik “Vojsava Zeneli” PF, nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Armand Sinani” PF për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-77994-08-21-2023, me objekt: “Këpuçë me qafa” për nevojat e shoqërisë “ILLYRIAN GUARD” Sh.A”, me fond limit 15,810,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 19.10.2023 nga autoriteti kontraktor, “Illyrian Guard” Sh.A.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Armand Sinani” PF, dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Armand Sinani” PF.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri